



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

U D H Ë Z I M

Nr.____, datë____.____.2026

**PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR VERIFIKIMIN E SAKTËSISË SË TË
DHËNAVE NË REGJISTRIN E LOBITIT DHE PËRDITËSIMIN E TYRE**

Në mbështetje të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 7 dhe pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

U D H Ë Z O N:

1. Ky udhëzim përcakton procedurat dhe afatet për verifikimin e saktësisë së të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Lobimit, si dhe përditësimin e tyre.
2. Komisioneri verifikon saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Lobimit, si dhe përputhshmërinë e tyre me raportet dhe dokumentacionin e depozituar pranë tij.
3. Verifikimi kryhet:
 - a) periodikisht, të paktën një herë në vit, sipas planit të verifikimeve të miratuar nga Komisioneri, mbi bazën e vlerësimit të rrezikut. Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të rrezikut, përzgjedhja e subjekteve për verifikim, si dhe mënyra dhe shpeshtësia e verifikimit të rasteve me nivele të ndryshme rreziku përcaktohen në metodologjinë e miratuar me urdhër të Komisionerit;
 - b) në rast të raportimit, sinjalizimit ose ankimit të paraqitur nga çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, si dhe të informacioneve të bëra publike nga mediat ose organizatat e shoqërisë civile;
 - c) kryesisht, kur gjatë administrimit të Regjistrit të Lobimit ose ushtrimit të funksioneve të tij, Komisioneri konstaton pasaktësi ose mospërputhje të të dhënave.
4. Verifikimi kryhet nga struktura përgjegjëse e Komisionerit, nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar dhe të çdo informacioni tjetër të administruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Gjatë verifikimit, struktura përgjegjëse e Komisionerit mund t’u kërkojë lobistëve dhe përfituesve të lobimit informacion, si dhe zyrtarëve publikë sqarime për kontaktet e zhvilluara me lobistët, kur kjo është e nevojshme për verifikimin e saktësisë dhe përditësimin të të dhënave në Regjistrin e Lobimit, në përputhje me nenin 21 të Ligjit.
6. Kur nuk konstatohen pasaktësi ose mospërputhje, struktura përgjegjëse e Komisionerit përfundon verifikimin.

7. Në rast konstatimi të pasaktësive, mospërputhjeve ose mungesës së të dhënave të detyrueshme që duhet të ishin deklaruar sipas ligjit, Komisioneri njofton menjëherë lobistin, i cili është i detyruar të marrë masat e nevojshme për korrigjimin e të dhënave brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, në përputhje me pikën 2 të nenit 22 të Ligjit.
8. Korrigjimi ose përditësimi i të dhënave sipas pikës 7 të këtij udhëzimi kryhet nëpërmjet Formularit “Njoftimi për korrigjimin ose përditësimin e të dhënave në Regjistrin e Lobimit”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si Aneksi nr. 2. Njoftimi shoqërohet me dokumentacionin përkatës, kur korrigjimi ose përditësimi kërkon provë dokumentare.
9. Pas korrigjimit të të dhënave nga lobisti, Komisioneri përditëson Regjistrin e Lobimit brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 8 të Ligjit.
10. Komisioneri fillon procedurën e hetimit administrativ:
 - a) kur, pas kalimit të afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh të parashikuar në pikën 2 të nenit 22 të Ligjit, pasaktësitë nuk janë korrigjuar dhe, nga vlerësimi i rrethanave të rastit, rezultojnë indicie për mosrespektimin e detyrimit ligjor për korrigjimin e të dhënave; ose
 - b) kur gjatë verifikimit rezultojnë indicie për shkelje të dispozitave të Ligjit.Hetimi administrativ zhvillohet në përputhje me Ligjin dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
11. Kur, në përfundim të hetimit administrativ, konstatohet një shkelje për të cilën Ligji parashikon përgjegjësi administrative, Komisioneri merr vendim të arsyetuar dhe, sipas rastit, vendos masën administrative përkatëse të parashikuar në nenin 24 të Ligjit, në përputhje me Ligjin dhe Kodin e Procedurave Administrative.
12. Vendimi administrativ u njoftohet palëve të interesuara në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
13. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen, kontrollin dhe verifikimin e veprimtarive të lobimit, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
14. Aneksi nr. 1 “Listë kontrolli për verifikimin e të dhënave në Regjistrin e Lobimit” dhe Aneksi nr. 2 “Formular njoftimi për korrigjimin ose përditësimin e të dhënave në Regjistrin e Lobimit” janë pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

Aneksi nr. 1 – dokument i brendshëm i specialistit (verifikimi)

LISTË KONTROLLI PËR VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË REGJISTRIN E LOBIMIT

Objekti i verifikimit: _____

Subjekti i verifikimit: _____

Data e fillimit të verifikimit: _____

Specialisti përgjegjës: _____

I. Verifikimi i regjistrimit

Nr.	Elementi i verifikimit	Po	Jo	Vërejtje
1	Lobisti është i regjistruar në Regjistrin e Lobimit			
2	Statusi i regjistrimit është aktiv			
3	Të dhënat identifikuese të lobistit përputhen me dokumentacionin e depozituar			

II. Verifikimi i të dhënave

Nr.	Elementi	Po	Jo	Vërejtje
1	Të dhënat janë të sakta			
2	Të dhënat janë të përditësuara			
3	Përfituesi i lobimit është deklaruar			
4	Autoriteti publik është deklaruar			
5	Fusha e veprimtarisë së lobimit është deklaruar			

III. Verifikimi i dokumentacionit të depozituar

Nr.	Elementi	Po	Jo	Vërejtje
1	Dokumentacioni i kërkuar sipas Ligjit është depozituar, kur është i zbatueshëm			
2	Dokumentacioni i depozituar përputhet me të dhënat e regjistruara			

IV. Rezultati i verifikimit

- ☐ Nuk janë konstatuar pasaktësi ose mospërputhje
- ☐ Janë konstatuar pasaktësi, mospërputhje ose mungesë e të dhënave të detyrueshme
- ☐ Janë konstatuar indicie për shkelje të Ligjit

Veprimi i propozuar

- ☐ Përfundimi i verifikimit
- ☐ Njoftimi i lobistit për korrigjimin ose përditësimin e të dhënave
- ☐ Kërkim informacioni shtesë ose sqarimeve të nevojshme
- ☐ Fillimi i procedurës së hetimit administrativ

Specialisti përgjegjës _____

Data _____

Shqyrtuar nga:

Datë _____

Aneksi nr. 2 – Formular që plotëson lobisti (korrigjimi/përditësimi)

FORMULARI: NJOFTIMI PËR KORRIGJIMIN OSE PËRDITËSIMIN E TË DHËNAVE NË REGJISTRIN E LOBIMIT

Drejtuar: Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

I. TË DHËNAT E LOBISTIT

Emri / Mbiemri / Emërtimi: _____

Numri i regjistrimit në Regjistrin e Lobimit: _____

NUIS (për personin juridik): _____

Adresa elektronike (e-mail): _____

Telefon: _____

II. TË DHËNAT QË KORRIGJOHEN OSE PËRDITËSOHEN

Shënoni të dhënë/të dhënat që korrigjohen ose përditësohen:

☐ Emri / Emërtimi

☐ Adresa e ushtrimit të veprimtarisë / Selia

☐ Përfaqësuesi ligjor

☐ Personat e punësuar si lobistë, në rastin e personit juridik

☐ Fusha dhe tematika e lobimit

☐ Përfituesi ose subjekti në emër të të cilit ushtrohet veprimtaria lobuese

☐ Institucionet publike ose kategoritë e zyrtarëve publikë me të cilët janë vendosur kontakte lobimi

☐ Të dhëna të tjera (specifikoni): _____

III. PËRSHKRIMI I KORRIGJIMIT OSE PËRDITËSIMIT

Të dhënat aktuale në Regjistër:

Të dhënat e korrigjuara ose të përditësuara:

Data e ndryshimit të të dhënave, kur është e zbatueshme: ____/____/_____

Data e paraqitjes së njoftimit: ____/____/____

IV. DOKUMENTACIONI BASHKËLIDHUR, SIPAS RASTIT

- ☐ Dokumentacion që lidhet me korrigjimin ose përditësimin e të dhënave
- ☐ Dokumentacion tjetër (specifikoni): _____

V. DEKLARIM

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë njoftim janë të sakta dhe të vërteta.

Vendi dhe data: _____

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____